

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	---	---

Datë/a:	07.06.2019
Për/ Za/ To:	ILIR KOSOVA
CC:	Departamenti i Prokurimit
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit - Komuna e Prishtinës 
Tema/ Subjekat/Subject:	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 05.06.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “ILIR KOSOVA”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “FURNIZIMI ME PAJISJE TEKNOLOGJIKE PËR OBJEKTET KOMUNALE DHE BASHKËSITË LOKALE”, me Nr. të Prok: 616 019 045 121 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet si e pa bazuar** kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik “ILIR KOSOVA”, të dt. 05.06.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit “FURNIZIMI ME PAJISJE TEKNOLOGJIKE PËR OBJEKTET KOMUNALE DHE BASHKËSITË LOKALE”, me Nr. të Prok: 616 19 045 121, kundër **vendimit të Autoritetit Kontraktues**, të datës 03.06.2019 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet vendimi i AK** për dhënien e kontratës të publikuar me datë: 03.06.2019.
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Ar sy e t i m

Pas kërkeses për rishqyrtim, Zyrtari përgjegjës i prokurimit ka shqyrtuar kërkesën e OE dhe duke u bazuar në faktin se pretendimet e tij kanë të bëjnë me vlerësimin teknik, ka kërkuar nga anëtarët profesionist të komisionit të analizojnë këto pretendime dhe të deklarojnë lidhur me të njëjtat.

Anëtarët profesionist të komisionit kanë analizuar pretendimet dhe kanë konstatuar se pretendimet janë të pabazuara.

Sqarimet lidhur me pretendimet e pabazuara janë paraqitur në tabelën në vijim:

	Ofertuesi - Ilir Kosova
Tek pozicioni nr. 2 modeli që është ofruar?	
-	Eshtë ofruar micro-tower, ndërsa nga komuna e Prishtinës është kërkuar mid-tower
	Ofertuesi - Ilir Kosova
1.1 Tek pozicioni nr. 2 modeli që është ofruar në kolonën C është LEXMARK MB2442DW.	
1.2 Eshtë kërkuar Double side copying: DADF.	
-	1.1 Kompania ka ofruar LEXMARK MB2442DW i cili nuk është printer AIO, ndërsa së bashku me ofertën ka ofruar një katalog me një lloj tjetër të printerit Lexmark MB2442adwe i cili nuk është i njëjtë me llojin që është ofruar në kolonën C ku është kërkuar të çeket me saktësi modeli i pajisjeve.
-	1.2 Eshtë ofruar RADF

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës, departamentit të prokurimit dhe njësisë së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

